



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 2418 Prot.

Tiranë, më 17.04 2019

**Lënda:** Kërkesë për plotësim dokumentacioni

**ZNJ. MAJLINDA LLAMBRO ÇAKALLI**  
Adresa: Këshilli i Bashkisë Sarandë

**Për dijeni:**

**KËSHILLIT TË BASHKISË SARANDË**  
Adresa: Rr. "Abedin Dino", nr. 11, Sarandë

**PARTISË LËVIZJA E LEGALITETIT**  
Adresa: Bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 89, datë 20.03.2019 "Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", vendosi: Të shpall moszgjedhshmërinë si anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, të z. Myzafer Ferrik Shameti".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vazhdoj procedurën me kandidatin e rradhës sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë, të cilit i kalonte mandati i Këshilltarit. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë, të cilit i kalonte mandati i Këshilltarit, ishte kandidati me numër rendor 04 (katër), znj. Arsela Besnik Llanaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1653 prot., datë 26.03.2019 i është drejtuar znj. Arsela Besnik Llanaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë, të cilës i kalon mandati i Këshilltares.

Me shkresën nr. 21 prot., datë 27.03.2019 Këshilli i Bashkisë Sarandë, njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se znj. Arsela Besnik Llanaj, ka depozituar deklaratë dorëheqje pranë Këshillit të Bashkisë Sarandë.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 05 (pesë), z. Erjon Vangjel Qurku, sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2155 prot., datë 03.04.2019 i është drejtuar z. Erjon Vangjel Qurku, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidat vijues i listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit.





Me shkresën nr. 28 prot., datë 12.04.2019 Këshilli i Bashkisë Sarandë, njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se z. Erjon Besnik Llanaj, ka depozituar deklaratë dorëheqje pranë Këshillit të Bashkisë Sarandë.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 06 (gjashtë), znj. Majlinda Llambro Çakalli, sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, për Këshillin e Bashkisë Sarandë.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumemërore për këshillin bashkiak për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë, kandidati i listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, znj. Majlinda Llambro Çakalli, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidatit, nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e saj. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me afishimin e kësaj shpallje, kandidatët vihet në dijeni për njoftimin e tyre për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Afati i dorëzimit fillon nga data e publikimit të kësaj shpallje.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me kreun II, pika 7, dhe kreun III, pika 2, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

